



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 773
Dt 08.06.2020

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 157 të Statutit të Përkohshëm, si dhe në zbatim të nenit 3 dhe nenit 7.1. të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 5.6.2020, mori:

VENDIM

1. **Dr. sc. Përparim Gruda** zgjidhet **profesor asistent** për lëndët: E drejta kushtetuese, Gjyqësia kushtetuese, Procedura administrative, E drejta e vetëqeverisjes lokale, Filozofia e së drejtës, Metodologjia dhe shkrimi ligjor, në Fakultetin Juridik.
2. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit dhe nenit 7.1. të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB.
3. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Zgjedhja zgjat për periudhën 4 (katër) vjeçare.
5. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet prej 8.6.2020, pas deklarimit për pagë primare në UMIB..

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimitdhënësi lëndët: E drejta kushtetuese, Gjyqësia kushtetuese, Procedura administrative, E drejta e vetëqeverisjes lokale, Filozofia e së drejtës, Metodologjia dhe shkrimi ligjor, në Fakultetin Juridik.

Këshilli i Fakultetit e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Përparim Gruda të zgjidhet profesor asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 5.6.2020, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që dr. sc. Përparim Gruda të zgjidhet profesor asistent për lëndët: E drejta kushtetuese, Gjyqësia kushtetuese, Procedura administrative, E drejta e vetëqeverisjes lokale, Filozofia e së drejtës, Metodologjia dhe shkrimi ligjor, në Fakultetin Juridik.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrës për çështje akademike

Prof. dr. Alush Musaj

